

“Krenaria Folklorike dhe Turistike e Lezhes”

Festat lokale tashmë po bëhen traditë në çdo komunitet. Erdhi radha pikërisht e “Festës së Venës Kallmet” në Lezhë.



E dielë më 15 Shtator 2019, ora 16:00 në ambientet e Shkollës “Shën Eufemia” në Kallmet ju ftojmë në eventin e radhës. Ju prezantojnë kulturën, traditën dhe krenarinë një komuniteti që trashëgon mjaft vlera dhe po përpiqemi t’i ruajmë të gjalla nga brezi në brez.



Ky aktivitet realizohet nga Fondacioni Mary Ward Loreto në kuadër të Projektit “Krenaria Folklorike dhe Turistike e Lezhes” e mbështetur nga Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor –ReLOaD- që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në bashkepunim me Bashkinë Lezhë.



Mos mungoni në Festën më të madhe të krahinës së Kallmetit .

Ju mirëpresim !